



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal

01 Nr.06-5820/1

Dt.28.04.2015

Dr a g a sh

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008), nenit 32.2 të Statutit të Komunës-Dragash 01 Nr.06-103/1 të dt.11.09.2008 e konform Vendimit 01 Nr.06-20905 të Kuvendit Komunal të dt.26.11.2014 për themelimin e Komisionit për emërtimin e institucioneve e objekteve publike me emrat e dëshmorëve të Komunës-Dragash, , pas shqyrtimit paraprak të Propozimit të Komisionit, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.28.04.2015, miraton këtë:

## V E N D I M

### Për emërtimin e objekteve publike me emrat e dëshmorëve të Komunës-Dragash

- I. **MIRATOHET PROPOZIMI** i Komisionit Komunal për emërtimin e institucioneve e objekteve publike të Komunës me emrat e dëshmorëve të Komunës-Dragash, si vijon:
  - 1.1. Shtëpia e Kulturës në Dragash emërtohet "Aburrahman Gërdellaj",
  - 1.2. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Dragash emërtohet "Adem Berisha",
  - 1.3. Shtëpia e Kulturës në Brodosanë emërtohet "Alajdin Xhezairi",
  - 1.4. Palestra Sportive në Dragash emërtohet "Tasim Krasniqi", dhe
  - 1.5. Biblioteka në Dragash emërtohet "Ymridin Qengaj"
- II. Për implemtimin e lëtij Vendimi përkujdesen drejtoratet përkatëse që u përkasin objektet-institucionet e lartpërmendura.
- III. Vendimi hynë në fuqi 15 ditë nga regjistrimi në protokolën e Zyrës së MAPL-it, si dhe publikimit në web-faqen e Komunës-Dragash.

I dërgohet:

- Drejtorateve komunale...-Dragash,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) - Prishtinë, dhe
- Arkivit

Kryesuesi i KK-së Dragash

*Shaban Shabani*

